



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR SEMAN

VENDIM

Nr. 10, datë 28.05.2026

**“PËR KORRIGJIMIN E NJË GABIMI NË LEJEN ME NR. 10,
DATË 27.05.2009, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 9, DATË
27.05.2009 “PËR MIRATIMIN PËR PËRDORIM TË REZERVAVE
UJORE PËR PRODHIM HIDROENERGJIE NË H/C NË
HIDROCENTRALET BOGOVËS, KOMUNA BOGOVË, QARKU
BERAT”, TË KËSHILLIT TË BASENIT UJËMBLEDHËS SEMAN**

Bazuar në pikën 2 të nenit 141, të Ligjit Nr.29/2024 “Për burimet ujore”, vendimit nr.319, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, si dhe në nenin 112, të Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli i Basenit Lumor Seman,

V E N D O S I:

1. Korrigjimin e afatit të vlefshmërisë në Lejen “Për përdorim rezerve ujore” me nr. 10, datë 27.05.2009, miratuar me Vendimin nr. 9, datë 27.05.2009, të Këshillit të Basenit Ujëmbledhës Seman, sipas afatit të përcaktuar në Kontratën e Koncesionit.
2. Vendndodhja e veprës së marrjes :

Nga GAUS në lejen e vitit 2003: X= 4429860; Y= 4493100; Z=327.5 m



Në KRGJSH: X= 514411.15; Y= 4492652.4; Z= 327.5 m

3. Asnjë trgues tjetër nuk ndryshon përveç gabimit të afatit të përcaktuar në Kontratën e Koncesionit.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBL SEMAN

ANDUEL XHINDI

